VENDIM
Nr.41, datë 20.8.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese ,
Hilmi Dakli, Anëtar i““
Zija Vuci, Anëtar i ““
Franc Jakova, Anëtar i““
Alfred Karamuço, Anëtar i““
Kristofor Peçi, Anëtar i ““
Ha1il Kopani, Anëtar i ““
Veli Budo, Anëtar i ““
me sekretare Arbenka La1ica, me datën 13.8.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dyer të hapura çështjen nr .47 Akti që i përket :
K Ë R K U E S : BAHRI KOLLÇAKU, i përfaqësuar nga ZZ.Ermir Dobiani e Mitat Canaj.

SUBJEKTE TË INTERESUAR :

1. KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga Z.Spartak Braho.
2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga ZZ. Kristaq Kume dhe Thimjo Kondi.
3. SPARTAK NGJELA, në mungesë.

OBJEKTI:

Shfuqizimin e vendimit nr.1385, datë 18. 7.1997 të Komisionit Qendror , Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesit e Z.Bahri Kollçaku të subjekteve të interesuara si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Bahri Kollçaku ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.1385, datë 18.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilin është shpallur pa të drejtë si deputet i dytë për mandatet shtesë të listës shumëemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, Z.Spartak Ngjela.

Kërkuesi në pretendimet e tij ka parashtruar se me Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë cënuar të drejta kushtetuese për të drejtën e zgjedhjes dhe të barazisë para ligjit, që parashikohen respektivisht nga nenet 19 e 25 të Ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

Gjykata konstaton se rezultatet përfundimtare të votimeve në shkallë kombëtare, si për zonat e listës njëemërore ashtu edhe për ato të ndarjes të 40 mandateve shtesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka shpallur me Vendimin nr.1385, datë 18.07.1997. Në këtë shpallje përmendet se nga lista shumëemërore për Partinë Lëvizja e Legalitetit, kanë fituar Guri Rapush Durollari dhe Spartak Kiço Ngjela.

Sipas nenit 50 të Ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", kundër Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese brenda tre ditëve nga dita e shpalljes së tyre. Kërkesa drejtuar kësaj Gjykate mban datën 4 gusht 1997, prandaj ajo është paraqitur jashtë afatit. Ky afat përderisa i referohet Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është i detyrueshëm për subjektet pavarësisht nga karakteri i shkeljes së të drejtës që pretendohet.

Në këto rrethana kërkesa duhet të rrëzohet si e paraqitur jashtë afatit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2 dhe 3 të ligjit nr.7561 , datë 29. 4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29. 4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së Z.Bahri Kollçaku si të paraqitur jashtë afatit.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
Tiranë, më 20. 8.1997